



11-5 U/A



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI JURIDIK

URDHËR

Nr. 15, datë 10.01.2019

PËR

“NJË NDRYSHIM NË URDHRIN E REKTORIT NR. 50, DATË 03.12.2018 MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Në zbatim të nenit 112 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të neneve 1 dhe 5 të ligjit nr.10289, datë 17.06.2010 për “Mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”; të nenit 2, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.06.2008 për “Zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës” (i ndryshuar); nenit 6 të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 për “Statusin e jetimit” (i ndryshuar); nenit 8 të ligjit nr. 8098 datë 28.03.1996 për “Statusin e të verbrit”(i ndryshuar); nenit 8 të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 për “Statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); nenit 12 të ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993 për “Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist” (i ndryshuar); nenit 32 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 për “Ndihmën dhe shërbimet shoqërore”(i ndryshuar) dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar),

URDHËROJ:

1. Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet e studimit në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, shtohet kriteri me përmbajtje si më poshtë vijon:
 - Përfitojnë bursë studentët e pranuar në vitin e parë akademik, për çdo program studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore mbi 9 (nëntë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Gjithashtu, përfitojnë bursë në masën e përcaktuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI JURIDIK

në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, studentët e regjistruar në çdo program studimi, në vitet pas të parit, me kriterin e notës mesatare mbi 9 (nëntë), të përlogaritur nga institucionet e arsimit të lartë, vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.”

2. Pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përfitojnë bursë, për vitin akademik 2018-2019, vetëm për kriterin e sipërcituar në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Afati i dorëzimit të aplikimeve nga ana e studentëve është deri në datën 16 Janar 2019, pranë zyrës së Drejtorisë Ekonomike në Rektorat.
4. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, grupi i punës I ngritur me urdhrin e Rektorit nr.50, Drejtorja Ekonomike, Dekanët dhe K/Sekretarët e Fakulteteve pranë Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Prof. Kastriot Çausi

REKTOR

UNIVERSITETI I ARTEVE